




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
OPSTINA E VITISË - OPŠTINA VITINA

30-10-2023  
01-110/05-1313



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d, neni 17, dhe neni 40 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), kërkesën e Ministrisë së Financave me Nr. 1653-1/2023, e datës 03.10.2023, nenin 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.10.2023 merr këtë:

## V E N D I M

**për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit me Nr.01-110/05-993, të datës 28.07.2023, për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues**

### Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për ndryshimin - plotësimin e Vendimit me Nr.01-110/05-993, të datës 28.07.2023 për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues.

### Neni 2

Konform nenit 1 të këtij vendimi, Vendimit me Nr.01-110/05-993, të datës 28.07.2023 për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues, duhet të plotësohet – ndryshohet, ku neni 2 i vendimit bazë ku thuhet: kodet me Nr.72654 (Serra 50m<sup>2</sup>-13700.00€), kodi me Nr.72709 (Grebujë me trakë,4980.00€), kodi me Nr.72711 (Spërkatëse 400L, 6360.00€), të krijuara për furnizim të pajisjeve nga neni 1 i këtij vendimi fshihen dhe plotësohen me kodet e tjera si:

Nr.	Emri i Projektit	Shumat totale të përfituar nga operatorët	% e participimit të përfituesve	Shuma për participim/komunitetit	Shuma për participim/komuna	kodi
1	Serra 50m <sup>2</sup>	68500,00 euro	20%	13700.00 euro,	54.800euro	92503
2	Spërkatëse 400L	31800.00 euro	20%	6360.00 euro	25400 euro	92500
3	Grebujë me trakë	24900.00euro	20%	4980.00 euro	19920.00 euro	92500
4	Multokultivator 4.4KW	27880.00 euro	20%	5516.00 euro	22064.00euro	92500
5	Pllug 755	23400.00 euro	20%	4680.00 euro	18720.00 euro	92500
6	Nxjerrës të patateve dy rendore	21950.00 euro	20%	43900.00 euro	17560.00 euro	92500
7	Fidane të Arrës	9296.00 euro	20%	1859.20 euro	7436.80 euro	92502

8	Centrifuga elektrike për mjalt	6700 euro	20%	1340.00 euro	5360.00 euro	92504
9	Shkrirëse dylli	10650 euro	20%	2130.00 euro	8520.00 euro	92504

### Neni 3

Të gjitha pjesët tjera të Vendimit Nr.01-110/05-993, të datës 28.07.2023 për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermeret përfitues mbeten në fuqi.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

### Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
2. Zyrës së Kryetarit;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi

